

**STATUT**  
**I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**MediCare Group-Sh.p.k.**

Në Këtë statut :

Ligji është Ligji Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.  
Statuti është Statuti i Shoqërisë.

**KREU I I**

**THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA, DHE ADRESA E FAQES SË INTERNETIT.**

**NENI 1**

**DATA E THEMELIMIT EMRI DHE THEMELUESIT**

1 - Sot me datë **05.08.2020** (Pesë Gusht, Dymjënënjëzetë), ditë e Mërkurë, **Unë**, Themeluesi, Barie **SALKURTI**, e bija i Ismetit, lindur me **14.02.1992** në Kastriot/Dibër, banues në qytetin “Peshkopi”, Njësia Administrative Peshkopi, **Bashkia/ Dibër**, zotëruese e Kartës së Identitetit **nr.personal/personal no.J25214007P**, kam krijuar këtë **STATUT** për **SHOQËRINË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR** me emrin : **MediCare Group-Sh.p.k.** të pështatur sipas ligjit **Nr.9901, datë 14.04.2008,”Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare**, për të zhvilluar aktivitet tregtar në fusha të ndryshme.

**Shoqëria është një person juridik shqiptar** që ushtron aktivitet privat në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë menëherë pas rregjistrimit në QKR(Qendra Kombëtare e Regjistrimit).

2 - Themelues i shoqërisë jam **Unë, Barie SALKURTI**, mbajtës i dokumentit të identitetit **nr.personal/personal no.J25214007P**, banuesE në qytetin Peshkopi, Bashkia Dibër.

**NENI 2**

**OBJEKTI I VEPRIMTARISË DO TË JETË :**

Tregtimi i barnave dhe produkteve farmaceutike në farmaci. Farmaci Tregtim pajisjesh mjeksore dhe farmaceutike si dhe aksesorët përkatës. Hapje e shfrytëzim qendra pushimi e kurative si dhe çdo veprimtari që lejohet me ligj. Në qoftë se shoqërisë për kryerjen e aktivitetit do t'i nevojitet leje përkatëse, shoqëria është e detyruar të pajiset paraprakisht me këtë leje nga organi kompetent.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë mbi 15 vjet (Pa afat).

**NENI 4**

**SELIA, ADRESA E FAQES SË INTERNETIT DHE ADRESA ELEKTRONIKE**

Shoqëria e ka SELINË në qytetin Peshkopi, **Bashkia/Dibër** në adresën : **Lagjja “Gjok Doçi”, Bulevardi “Eles Isufi”, Z.K.Nr.2932, Ndërtesa Nr.04/përballë kinemasë Peshkopi.**

Adresa e Faqes së Internetit të shoqërisë është : .....

Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është : **barie.salkurti@gmail.com**

BARIE

SALKURTI

## KREU i II

### *KAPITALI I REGJISTRUAR*

#### NENI 5

##### *VLERÄ DHE PAGESA E KAPITALIT TË REGJISTRUAR*

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është : 1000 Lek (Njëmijëlekë).

Pjesëmarrja e Ortakut të Vetëm Themelues në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e formuar tërësisht nga Ortakut i Vetëm Themelues **Znj. Barie SALKURTI** në masën 100% të vlerës së tij.

Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij si më poshtë :

Ortaku i Vetëm themelues, **Znj Barie SALKURTI** është zotëruese e një **KUOTË TË VETME** me vlerë të përgjithëshme **1000 Lek** (Njëmijëlekë), që përbën **100%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributet në Para janë paguar plotësisht me kontributin e Ortakut të Vetëm Themelues **Znj. Barie SALKURTI**, që në momentin e regjistrimit fillestar.

Pagesat e kontributeve në Para kryhen në llogarinë Nr. \_\_\_\_\_ pranë degës së “\_\_\_\_\_ -BANK” - Peshkopi.

Fitimi i realizuar nga ushtrimi i veprimtarisë ekonomike të shoqërisë do të administrohet nga Ortaku i Vetëm Themelues **Znj. Barie SALKURTI**. Një pjesë e këtij fitimi mund të përdoret për zgjerimin e aktivitetit tregtar.

Shoqëria është e detyruar të shlyejë të gjitha detyrimet që ka ndaj shtetit dhe të tretëve.

#### NENI 7

### *TRANSFERIMI I KAPITALIT*

Kuotat e kapitalit të një Shoqërisë më Përgjegjësi të Kufizuar e të drejtat që rrjedhim prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet :

- a) - kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) - shitblerjes
- c) - trashëgimisë
- ç) - dhurimit
- d) - çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie

## KREU i III

### *ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE*

#### NENI 8

### *ORGANI VENDIMMARRËS*

Asambleja e Ortakëve (**Ortaku themelues**) është organi **i vetëm vendimmarrës** i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modalitetave të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve (Ortaku themelues) është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të shoqërisë për çështjet e mëposhtme :

- 1) - përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
- 2) - emërimin e shkarkimin e administratorëve
- 3) - emërimin e shkarkimin e likuidueve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 4) - përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në pikat 2 dhe 3 të këtij nenit.

*BARIE SALKURTI* *B*

- 5) - mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- 6) - miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- 7) - zmadhimin dhe zvoglimin e kapitalit.
- 8) - pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- 9) - përfaqsimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.
- 10) - riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 11) - miratimin e3 rregullave procedural të mbledhjeve të asamblesë.
- 12) - çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqsues i Ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## **NENI 9**

### ***MËNYRA E THIRRJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHËSHME***

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur Asambleja e Përgjithëshme nuk është thirrur sipas pikes 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## **NENI 10**

### ***KUORUMI***

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithëshme mund të marrë vendime vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetëpërqind) të kuotave.

Në rastin kur Asambleja e Përgjithëshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikes 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithëshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite

## **NENI 11**

### ***MARRJA E VENDIMEVE***

Asambleja e Përgjithëshme vendos me  $\frac{3}{4}$  (tri të katërtat) e votave të zotëruarve të kapitalit të ortakëve pjesëmarrës për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit të regjistruar, shpëndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithëshme (Ortaku themelues) vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) - përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë
- b) - emërimin dhe shkarkimin e administratorëve
- c) - emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar

ç) - përcaktimin e shpërblimeve

d)- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.

e) - perfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve

f) - miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR-së për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

## NENI 12

### PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithëshme merr vendim për :

a) - vlerësimin e veprimtarisë së tij

b) - shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij.

c) - ngritjen e ndonjë padie ndaj tij nga shoqëria

ç) - dhënen ose jo të përfitimeve të reja

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## NENI 13

### ADMINISTRIMI

(1).Asambleja e Përgjithëshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.Afat i emërimit është 5 (pesë) vjet me të drejtë ripërtëritje.Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2).Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcatimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

3 – Administrator i shoqërisë do të jetë **Znj. Barije SALKURTI**.

Administratori qëndron në detyrë për një periudhë pesëvjeçare (5) me të drejtë ripërtëritje, duke filluar afatin e qëndrimit në detyrë që me datën **05.08.2020** deri me datën **05.08.2025**

## NENI 14

### KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE(ADMINISTRATORES)

Administratorët (Administratori) kanë (ka) të drejtë e detyrohen(t) të :

a) -Të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithëshme

b )-Të përfaqësojnë shoqërinë tregtare

c) -Të kujdesen (t) për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe librave kontabël të shoqërisë.

ç) - Të përgatisin (së) dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe reportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqesin dokumentat përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim.

d) - Të krijojnë një sistem parajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë.

dh) - Të kryejnë (ë) regjistrimet dhe dërgojnë (jë) të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

e) - Të raportojnë para asamblesë së përgjithëshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme më rendësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.

BARIE

SALKURTI



ë) - Të kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe statut.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithëshme në raste kur :

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda (3) muajve në vazhdim.

- Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër, aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se **5% (pesëpërqind)** të **aseteve të shoqërisë**, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse Asambleja e Përgjithëshme emëron më shumë se një administrator, **ata** e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e Përgjithëshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme (thjeshtë).

Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## NENI 15

### PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht, sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, administratori detyrohet :

1. a) Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe statut në mirëbesim dhe në interesin më mirë të shoqërisë në tërësi duke i kushtuar vemendje të veçantë ndikimit të veprimitarës së shoqërisë në mëdis.

b) Të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita.

c) Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim.

c) Të parandalojë dhe të mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundëshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë.

d) Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që (ai) ata apo personat e lidhur me (të) ta, kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme :

a) U kthen ortakëve kontributet.

b) U paguan ortakëve interesa apo dividentë.

- c) U shpérndan aktivet e shoqërisë.
- c) Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet.

d) Jep kredi

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët, individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrënë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin finanziar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkësë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

## KREU I IV

### VITI FINANCIAR-EKSPERTËT

#### NENI 16

#### VITI FINANCIAR

Viti finanziar i Shoqërisë fillon me **01 Janar** dhe përfundon me **31 Dhjetor**. Përjashtimisht, viti **i parë finanziar** fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbylljet me **31 Dhjetor**.

#### NENI 17

#### EKSPERTËT

Eksperti ka për detyrë që kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë, i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Nër përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor, si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

## KREU I V

### PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHQËRISË

#### NENI 18

#### PRISHJA dhe LIKUIDIMI

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj.
- b) Me vendim të asamblesë së ortakëve
- c) Me hapjen e procedurave të falimentimit
- c) Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për 2 (dy) vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".
- d) Me vendim të gjykatës :

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, **duke caktuar** 1 (një) ose disa likuidatorë **dhe shënuar** në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "**Shoqëri në likuidim e sipër**".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### **NENI 19**

#### ***RIORGANIZIMI I SHOQËRISË, BASHKIMI-NDARJA***

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithëshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën e IX të Ligjit Nr.9901, datë 14.02.2012 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” në Republikën e Shqipërisë.

#### **NENI 20**

#### ***BAZA LIGJORE***

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, “Kodi Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### **NENI 21**

#### ***MOSMARRËVESHJET***

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Ky statut është përpiluar në katër kopje me vlerë të njëjtë me originalin dhe është nënshkruar me vetëdije dhe vullnet të plotë prej meje personalisht.

**ORTAKU i VETËM  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
MediCare Group-Sh.p.k.  
Barie SALKURTI**

Peshkopi, me 5 Gusht 2020

BARIE

SALKURTI

